

Agjërimi sipas pesë medhhebeve

Muhammed Xhevad Mughnijeh

al-Tawhid Journal, vëll. IX, nr. 4, Shewwal – Dhu'l-Hixhheh 1412

Agjërimi gjatë muajit të Ramazanit është ndër shtyllat e fesë islame. Nuk nevojitet provë për qenien e tij i detyrueshëm (*waxhib*) dhe mohuesi i tij del jashtë Islamit, sepse ai është i vetëkuptueshëm sikurse namazi, ku lidhur me diçka të vërtetuar kaq qartë, si të diturit ashtu edhe analfabetët, të vjetrit e të rinjtë, janë të gjithë të një mendimi.

Ai u deklarua detyrim (*farz*) i obligueshëm në vitin e dytë të hixhretit, mbi çdo të rritur të shëndetshëm nga mendtë dhe trupi (*mukalef*), ku prishja e tij (*iftar*) nuk lejohet përveçse në rastet e mëposhtme:

1. *Hajdhi* (*perodat mujore*) e *nifasi* (*lehona*): Shkollat pajtohen se agjërimi nuk është i vlefshëm për gratë gjatë të përmuajshmeve dhe lehonisë.

2. *Sëmundje*: Lidhur me këtë, shkollat dallojnë. Imamitë vërejnë: agjërimi nuk është i vlefshëm nëse shkakton apo rëndon sëmundje, apo forcon dhimbjet ose vonon shërimin, sepse sëmundja nënkupton lëndim (*darar*) dhe lëndimi është i ndaluar (*haram*). Për më tepër, një ndalim i lidhur me një adhurim (*'ibadeh*) e zhvleftëson atë. Ndaj, nëse personi agjëron në kushte të tilla, agjërimi i tij nuk është i vlefshëm (*sahih*). Një mundësi serioze shkaktimi ose rëndimi i një sëmundjeje mjafton për t'u përmbajtur nga agjërimi. Sa i përket dobësisë së tepruar, ajo nuk përbën përligjeje për *iftar*, për sa kohë që është e durueshme. Kësisoj, shkaku ndërprerës është sëmundja e jo dobësia, mundimi ose rëndesa, sepse çdo detyrë përfshin vështirësi dhe mosrehati.

Katër shkollat sunnite pohojnë: nëse agjëruesi (*sa'im*) sëmuret, ose i druhet rëndimit të sëmundjes, apo vonimit të shërimit, ai mund të zgjedhë të agjërojë ose jo. Ai s'e ka të detyrueshëm ndërprerjen (*iftar*); e cila në këtë rast përbën lehtësim, jo obligim. Mirëpo aty ku ekziston mundësi vdekjeje ose humbjeje të cilësdo shqisë, iftari është obligim dhe agjërimi i tij nuk vlen.

3. Gruaja në etapën e fundit të shtatzanisë dhe nënat gjidhënëse. Katër medhhebet pohojnë: nëse një grua shtatzënë ose gjidhënëse frikësohet për shëndetin e saj ose të fëmijës, agjërimi i saj vlen, ndonëse i lejohet të përmbahet prej tij. Nëse ajo zgjedh ta ndërpresë, shkollat pajtohen se ajo nuk e ka për detyrë të agjërojë *kada'* më vonë. Ato dallojnë lidhur me zëvendësimin (*fidjeh*) dhe shlyerjen (*kaffareh*) e tij. Rreth kësaj, hanefitë vërejnë: nuk është aspak *waxhib*. Malikitë janë të mendimit se është *waxhib* për një grua gjidhënëse, por jo për shtatzënë.

Hanbelitë dhe shafi'itë pohojnë: *Fidja* është *waxhib* për një shtatzënë e një gjidhënëse vetëm nëse ato i druhen rrezikut për fëmijën; por nëse i druhen dëmit ndaj shëndetit të tyre si dhe të fëmijës, ato e kanë për detyrë vetëm të agjërojnë *kada'*, pa patur nevojë të japin *fidjeh*. *Fidjeh* e çdo dite është një *mudd*, pra sasia e ushqimit të një nevojtarit (*miskin*).^[1]

Imamitë pohojnë: nëse një shtatzënë pranë lindjes ose fëmija e një gjdhënëseje mund të pësojnë dëm, të dyja duhet ta ndërpresin agjërimin, i cili nëse vazhdohet nuk vlen, për shkak të palejueshmërisë së lëndimit. Ata pajtohen se të dyja duhet të agjërojnë *kada'* dhe të japin *fidjeh* sa një *mudd*, nëse i druhen lëndimit të fëmijës. Por nëse dëmi nga i cili ekziston frika lidhet vetëm me personin e saj, disa imami pohojnë se ajo duhet të agjërojë *kada'* por jo të japë *fidjeh*, ndërsa të tjerë mendojnë se ajo e ka detyrim edhe *kada'në* edhe *fidjen*.

4. Udhëtimi, me kusht që të plotësohen kushtet e nevojshme për *salatu'l-kasr*, sipas opinionit të çdo medhdhebi. Shkollat sunnite i shtojnë një kusht të mëtejshëm këtyre, duke thënë se udhëtimi duhet të fillojë përpara agimit dhe udhëtari duhet ta ketë arritur pikën ku namazi bëhet *kasr*, përpara agimit. Kështu, nëse e fillon udhëtimin pas agimit, ai e ka *haram* të prishë agjërimin, dhe nëse e thyen, do të obligohet me *kada'në* e saj, pa *kaffarah*. Shafi'itë shtojnë një tjetër kusht, gjegjësisht se udhëtari nuk duhet të jetë udhëtar i vazhdueshëm, si për shembull shofer. Kësisoj, nëse e ka zakon të udhëtojë, atij nuk i lejohet të ndërpresë agjërimin. Sipas të katër shkollave sunnite, prishja e agjërimit është me dëshirë, jo e detyrueshme. Prandaj, një udhëtar që plotëson të gjitha kushtet ka mundësinë që të agjërojë ose jo, megjithë faktin se hanefitë vërejnë se kryerja e namazit *kasr* gjatë udhëtimit është e detyrueshme e jo me dëshirë.

Imamitë pohojnë: nëse plotësohen kushtet për t'u falur *kasr*, agjërimi nuk pranohet. Prandaj, nëse agjëron, atij do t'i duhet të kryejë *kada'* pa u detyruar me *kaffarah*. Kjo, në rastin kur udhëtimi i tij fillon para mesditës. Mirëpo, nëse niset në mesditë ose më vonë, ai do ta vazhdojë agjërimin, të cilin nëse e ndërpret do të duhet ta shlyejë me *kaffaranë* e atij që thyen agjërimin me dashje. Dhe, nëse udhëtari arrin në shtëpi (ose në një vend ku synon të rrijë të paktën dhjetë ditë) përpara mesditës, pa patur kryer asnjë veprim që e prish agjërimin, ai e ka *waxhib* ta vazhdojë agjërimin, të cilin nëse e ndërpret, duhet ta shlyejë si personi që e ka thyer me dashje.

5. Ekziston njëzëshmëri mes të gjitha shkollave se ai që vuan nga sëmundje etjeje akute mund ta ndërpresë agjërimin dhe, nëse mund ta kryejë *kada'në* më vonë, ajo do t'i jetë *waxhib* pa ndonjë *kaffarah*, sipas katër medhhebeve. Imamitë mendojnë se ai duhet të japë një *mudd* si *kaffarah*. Medhhebet dallojnë mbi atë nëse uria akute është ndër arsyet që lejojnë ndërprerjen e agjërimit, sikurse etja. Katër shkollat thonë se uria dhe etja janë të ngjashme, duke e bërë të lejueshme ndërprerjen. Imamitë pohojnë: uria nuk është shkak që lejon ndërprerjen e agjërimit, përveçse kur pritet të shkaktojë sëmundje.

6. Të moshuarit e të moshuarat në vitet e thyera, për të cilët agjërimi është i dëmshëm e i vështirë, mund ta ndërpresin agjërimin, por obligohen me *fidjeh* duke ushqyer një *miskin* për çdo ditë të humbur. Kështu duhet të veprojnë edhe i sëmuri që nuk ka shpresë të përmirësohet gjatë tërë vitit. Mbi këtë rregull pajtohen të gjitha shkollat, përveç hanbelive, të cilët pohojnë: *fidjeh* është *mustehabb* e jo *waxhib*.

7. Imamitë pohojnë: agjërimi nuk është *waxhib* për atë që është në vilani, edhe nëse ajo ndodh vetëm në një pjesë të ditës, përveçse kur ai e ka bërë nijjetin e agjërimit përpara dhe e merr veten më pas, me ç'rast do të vazhdojë të agjërojë.

Zhdukja e përlijjes:

Nëse përlijja e ndërprerjes së agjërimit resht - si p.sh. kur i sëmuri shëndoshet, fëmija piqet, udhëtari kthehet ose të përmuajshmet sosen - është *mustehabb* sipas imamive dhe shafi'ive që të përmbahet (*imsak*) nga gjërat që e ndërpresin agjërimit (*muftirat*), si shenjë respekti. Hanbelitë dhe hanefitë e konsiderojnë *imsakun waxhib*, ndërsa malikitë as *waxhib* as *mustehabb*.

Kushtet (*shurūt*) e agjërimit:

Siç u përmend më lart, agjërimit në muajin e Ramazanit është *waxhib* për secilin *mukalef*. Çdo i rritur i shëndoshtë nga mendja (*el-baligh el-'akil*) konsiderohet *mukalef*. Prandaj agjërimit as nuk është *waxhib* për një të çmendur e as nuk vlen nëse e kryen. Sa për fëmijën, ai nuk është *waxhib* për të, ndonëse bëhet i vlefshëm nëse kryhet nga një *mumajjiz* (*dallues*). Gjithashtu, për vlefshmërinë e agjërimit është thelbësor të qenit musliman dhe qëllimi (*nijjeh*). Kësisoj, sipas njëzëshmërisë, as agjërimit jomuslimanit e as *imsaku* i atij që s'ka bërë *nijjeh* nuk pranohet. Kjo pavarësisht nga kushtet e lartpërmendura, si mospatja e të përmuajshmeve, lehonisë, sëmundjes dhe udhëtimit.

Sa i përket personit në gjendje të dehur ose të pavetëdijshme, shafi'itë vërejnë: agjërimit i tij nuk vlen nëse ai nuk është i ndërgjegjshëm gjatë gjithë periudhës së agjërimit. Por nëse është i vetëdijshëm për një pjesë të saj, agjërimit i tij është i vlefshëm, megjithëse i pavetëdijshmi obligohet me *kada'në* e saj, cilatdo qofshin rrethanat, pavarësisht nëse ndërgjegjësimi i tij bëhet vetë apo imponohet. Por *kada'* ja nuk është *waxhib* për një të dehur, përveç nëse ky është përgjegjësi për gjendjen e vet.

Malikitë pohojnë: agjërimit i tij nuk vlen nëse gjendja e pavetëdijshme ose dehjes zgjat për krejt ditën ose pjesën më të madhe të saj. Por nëse ajo përfshin gjysmën e ditës ose më pak dhe ai ishte i vetëdijshëm në çastin e nijjetit por nuk e bëri nijjetin, duke u dehur ose zhvetëdijësuar më vonë, *kada'* ja nuk është *waxhib* për atë. Sipas tyre, koha e bërjes së nijjetit të agjërimit zgjatet nga muzgu në agim.

Sipas hanefive, një i pavetëdijshëm është tamam si i çmenduri në këtë aspekt dhe opinioni i tyre lidhur me këtë të fundit është që nëse çmenduria zgjat për tërë muajin e Ramazanit, ai nuk e ka *waxhib kada'në*, e nëse ajo mbulon gjysmën e muajit, ai do të agjërojë për gjysmën tjetër dhe do të kryejë *kada'në* e agjërimeve të humbura për shkak të çmendurisë.

Hanbelitë vërejnë: *Kada'* ja është *waxhib* për një person në gjendje pavetëdijeje si dhe dehjeje, pavarësisht nëse ato gjendje i janë imponuar nga jashtë apo i ka shkaktuar vetë.

Sipas imamive, *kada'* ja është *waxhib* mbi një person të dehur, pavarësisht nëse është dehur vetë apo tjetërsoj dhe s'është *waxhib* për një të pavetëdijshëm edhe sikur humbja e vetëdijshme të tij të jetë e shkurtër.

***Muftirat* (prishëset e agjërimit):**

Janë gjërat, përmbajtja nga të cilat është e detyrueshme gjatë agjërimit, nga agimi deri në muzg:

1. Të ngrënit e të pirit (*shurb*) me qëllim. Të dy e zhvleftësojnë agjërimit dhe obligojnë *kada'* sipas të gjitha shkollave, ndonëse ato dallojnë lidhur me atë nëse edhe *kaffaraja* është *waxhib*. Hanefitë dhe imamitë e konsiderojnë të tillë, ndërsa shafi'itë e hanbelitë jo.

Një person që ha dhe pi nga pakujdesia nuk detyrohet as me *kada'* as me *kaffarah*, përveçse te malikitë, të cilët obligojnë vetëm *kada'në* e saj (te pirja [*shurb*] përfshihet edhe marrja e tymit të duhanit).

2. Marrëdhënia seksuale e qëllimshme e zhvleftëson agjërimit dhe obligon *kada'* dhe *kaffarah*, sipas të gjitha shkollave.

Kaffarah është lirimi i një shërbëtori e nëse kjo është e pamundur, agjërimit për dy muaj rresht, e nëse as kjo nuk është e mundur, ushqyerja e gjashtëdhjetë të varfërve. Imamitë dhe malikitë lejojnë zgjedhjen e njëres prej këtyre, pra një *mukalef* mund të zgjedhë midis lirimit të një shërbëtori, agjërimit ose ushqyerjes së të varfërve. Shafi'itë, hanbelitë dhe hanefitë obligojnë *kaffarah* sipas renditjes së mësipërme; pra lirimi i një shërbëtori është specifikisht *waxhib*, ku në rast pamundësie agjërimit bëhet *waxhib*. Nëse as kjo nuk është e mundur, të ushqyerit i të varfërve bëhet *waxhib*.

Imamitë pohojnë: të tre *kaffaratë* bëhen *waxhib* së bashku nëse akti i agjërimitprishjes (*muftir*) është vetë *haram*, si p.sh. ngrënia e diçkaje të uzurpuar (*maghsab*), të pirit e verës, ose zinaja.

Sa i përket marrëdhënies seksuale nga pakujdesia, ajo s'e prish agjërimit sipas hanefive, shafi'ive dhe imamive, por e zhvleftëson sipas hanbelive dhe malikive.

3. Derdhja seminale (*el-'istimna'*): Ekziston pajtim se ajo e zhvleftëson agjërimit nëse kryhet me dashje. Hanbelitë pohojnë: nëse del *madhj* nga shikime të përsëritura epshore apo të ngjashme, agjërimit zhvleftësohet.

Katër shkollat pohojnë: derdhja seminale obligon *kada'* pa *kaffarah*. Imamitë thonë se duhet edhe *kada'* edhe *kaffarah*.

4. Vjellja: e zhvleftëson agjërimit nëse bëhet me dashje, ndërsa sipas imamive, shafi'ive dhe malikive, ajo obligon edhe *kada'*. Hanefitë pohojnë: të vjellurit me dashje nuk e prish agjërimit, përveçse kur të vjellurit mbush gojën. Nga Imam Ahmedi, ndërkaq janë raportuar dy opinione. Shkollat pajtohen se të vjellurit pa dashje nuk e zhvleftëson agjërimit.

5. Hedhja e kupave (*hixhameh*) është *muftir* vetëm sipas hanbelive, të cilët vërejnë: edhe lëshuesi i kupave edhe pacienti kanë prishur agjërimit.

6. Injeksioni e zhvleftëson agjërimit dhe kërkon *kada'*, sipas të gjitha shkollave. Disa juristë imami vërejnë se ai kërkon edhe *kaffarah*, nëse nuk është marrë si masë urgjente.

7. Thithja e një reje të dendur pluhuri të pezullt e zhvleftëson agjërimin sipas imamive, të cilët pohojnë: nëse një pluhur i dendur i pezullt, si p.sh. miell ose diçka e tillë, hyn në trup, agjërimi zhvleftësohet, sepse ajo është më e lëndshme sesa injeksioni ose tymi i duhanit.

8. Lyerja me *kohl* zhvleftëson agjërimin vetëm sipas malikive, me kusht që të jetë bërë gjatë ditës dhe që shija t'i ndjehet në fyt.

9. Nijjeti për të ndërprerë agjërimin: nëse dikush synon të ndërpresë agjërimin dhe pastaj përmbahet nga ndërprerja, agjërimi i tij konsiderohet i pavlefshëm sipas imamive dhe hanbelive; por jo sipas medhhebeve të tjera.

10. Shumica e imamive pohojnë: zhytja e plotë e kokës, veçmas ose bashkë me pjesë të tjera të trupit, në ujë, zhvleftëson agjërimin dhe kërkon edhe *kada'* edhe *kaffarah*. Shkollat e tjera juridike e konsiderojnë atë si pa pasoja për agjërimin.

11. Imamitë pohojnë: personi që rri *xhunub* me dashje pas agimit në muajin e Ramazanit e zhvleftëson agjërimin e tij dhe *kada'*ja e *kaffaraja* do t'i jenë *waxhib*. Shkollat e tjera pohojnë se agjërimi i tij mbetet i vlefshëm dhe ai nuk obligohet me asgjë.

12. Imamitë pohojnë: personi që i mvesh me dashje diçka të pavërtetë Zotit ose të Dërguarit (s.a.) [pra nëse thotë ose shkruan se Zoti ose Pejgamberi (s.a.v.s) kanë thënë kështu e ashtu, duke qenë i ndërgjegjshëm se kjo nuk është e vërtetë], e zhvleftëson agjërimin e tij dhe obligohet me *kada'* e *kaffarah*. Një grup juristësh imami shkojnë më tej duke i kërkuar një shpifësi të tillë *kaffaranë* e të liruarit të një robi, agjërimin dy muaj rresht dhe ushqyerjen e gjashtëdhjetë të varfërve. Kjo masë tregon injorancën dhe ligësinë e atyre që thonë se imamitë e lejojnë thënien e gënjeshtreve ndaj Zotit dhe të Dërguarit të Tij (s.a.v.s).

Llojet e ndryshme të agjërimeve:

Juristët e shkollave të ndryshme i klasifikojnë agjërimet në katër kategori: *waxhib* (i detyruar) *mustehabb* (i pëlqyeshëm), *muharrem* (i ndaluar) e *mekruh* (i papëlqyeshëm).

Agjërimet e detyruara:

Të gjitha shkollat pajtohen se agjërimet *waxhib* janë ato të muajit të Ramazanit, *kada'*të e tyre, agjërimet shlyese të kryera si *kaffarah*, dhe ato që kryhen për të mbajtur një zotim. Imamitë shtojnë edhe dy, të lidhura me Haxhin dhe *i`tikafin*.

Më poshtë vijon diskutimi i *kada'*së dhe *kaffarasë* që i obligohen prishësit të agjërimit. Lloje të tjera të agjërimeve të detyrueshme janë diskutuar në kapitujt përkatës.

Kada'ja e agjërimeve të humbura në Ramazan:

1. Medhhebet pajtohen se i obliguari me *kada'* të agjërimeve të Ramazanit duhet t'i

kryejë ato gjatë po atij viti në të cilin i ka humbur, pra para se të vijë Ramazani vijues. Ai është i lirë t'i zgjedhë ditët në të cilat synon të agjërojë, duke përjashtuar ato kur agjërimi ndalohet (të cilat do të diskutohen më poshtë). Mirëpo ai e ka *waxhib* t'i fillojë menjëherë *kada'* të e tyre, nëse ditët e mbetura deri në fillimin e Ramazanit vijues janë të barabarta me numrin e agjëtimeve të humbura në Ramazanin e shkuar.

2. Nëse personi që e ka të mundur të kryejë *kada'* në brenda vitit e neglizhon atë deri në Ramazanin e ardhshëm, ai duhet të agjërojë këtë të fundit dhe pastaj të kryejë *kada'* në e vitit të shkuar si dhe të japë *kaffarah* një *mudd* për çdo ditë të humbur - sipas të gjitha shkollave, përveç hanefive, të cilët i kërkojnë vetëm *kada'* pa asnjë *kaffarah*. E nëse nuk është në gjendje të kryejë *kada'* - si p.sh. kur sëmundja i zgjat në tërë periudhën ndërmjet Ramazanit të parë e të dytë - atij nuk i kërkohet as *kada'* e as *kaffarah*, sipas të katër shkollave, ndërsa imamitë pohojnë: ai nuk do të obligohet me *kada'* por me dhënien e një *mudd* ushqim si *kaffarah* për çdo agjërim të humbur.

3. Nëse personi e ka të mundur kryerjen e *kada'* së gjatë vitit por e shtyn atë, me nijjetin e kryerjes së saj menjëherë përpara Ramazanit vijues, në mënyrë që agjërimet *kada'* vijohen fill nga Ramazani i ardhshëm, por një arsye e ligjshme e pengon nga kryerja e *kada'* së para ardhjes së Ramazanit, ai obligohet vetëm me *kada'* e jo me *kaffarah*.

4. Për atë që ndërpret një agjërim Ramazani me arsye dhe më vonë është në gjendje të kryejë *kada'* në por nuk ia arrin gjatë jetës së tij, imamitë pohojnë: është *waxhib* për fëmijën e tij më të madh ta kryejë *kada'* në në emër të prindit.

Hanefitë, shafi'itë dhe hanbelitë pohojnë: në emër të tij duhet dhënë një *mudd sadakah* për çdo agjërim të humbur.

Sipas malikive, kujdestari i tij ligjor (*wali*) do të japë *sadakah* në emër të tij, nëse ai ka porositur kështu në testament; por në mungesë të këtij nuk është *waxhib*.

5. Sipas katër medhhebeve, një person që kryen *kada'* të Ramazanit mund ta ndryshojë nijjetin e tij dhe ta ndërpresë agjërimin si para, ashtu edhe pas mesditës, pa u obliguar me ndonjë *kaffarah*, me kusht që të ketë kohë për ta kryer *kada'* në më vonë.

Imamitë vërjnë: atij i lejohet të ndërpresë agjërimin vetëm paradite e jo më vonë, sepse vazhdimi i agjërimit bëhet i detyrueshëm pas kalimit të pjesës më të madhe të tij, e cila i jep fund edhe kohës së ndryshimit të nijjetit. Prandaj, nëse vepron në kundërshtim me këtë dhe e ndërpret agjërimin pas mesditës, ai obligohet me *kaffarah* duke ushqyer dhjetë të varfër; nëse nuk është në gjendje ta kryejë këtë, do të agjërojë për tri ditë.

Agjërimi shlyejtës (*kaffarah*):

Agjërimet shlyese janë disa llojesh. Mes tyre janë agjërimet e pendesës për vrasje pa dashje, agjërimet për shlyerje të betimit ose zotimit të shkelur dhe agjëtime pendese për *zihar*. Këto agjëtime kanë rregullat e tyre, të cilat diskutohen në kapitujt përkatës. Këtu do të diskutojmë rregullat e zbatueshme mbi personin që agjëron *kaffarah* për të shlyer mosagjërimin e Ramazanit.

Shafi'itë, malikitë e hanefitë pohojnë se atij që i është bërë *waxhib* agjërimi i dy muajve të njëpasnjëshëm për prishje të një agjërimi në Ramazan nuk i lejohet të humbasë as edhe një ditë gjatë këtyre dy muajve, pasi kjo do ua ndërpriste vazhdimësinë. Ndaj nëse e ndërpret agjërimin, me ose pa arsye, ai duhet të agjërojë sërish për dy muaj pa ndërprerje.

Hanbelitë pohojnë: nëse humbet një agjërim me arsye, vazhdimësia nuk thyhet.

Imamitë pohojnë: për vazhdimësinë mjafton të agjërohet për një muaj të plotë dhe një ditë nga muaji tjetër. Paskëtaj, ai mund të kapërcejë ditë dhe pastaj të vazhdojë aty ku e ka lënë. Mirëpo nëse humbet një agjërim gjatë muajit të parë, pa arsye, ai duhet të fillojë sërish; por nëse kjo është bërë për ndonjë arsye të lejuar, si sëmundja ose menstruacionet, vazhdimësia nuk thyhet dhe ai/ajo do presë gjersa arsyeja largohet dhe do të rifillojë agjërimet.

Imamitë pohojnë më tej se ai që nuk mund të agjërojë për dy muaj ose të lëshojë një rob apo të ushqejë gjashtëdhjetë të varfër, ka zgjedhjen: ose të agjërojë 18 ditë ose të japë *sadakah* sipas mundësisë. Nëse nuk mundet as kaq, ai mund të japë lëmoshë ose të agjërojë sa të mundet. Nëse këto i janë të pamundura, ai duhet të kërkojë falje nga Zoti i Madhërishtëm.

Shafi'itë, malikitë dhe hanefitë pohojnë: nëse nuk mund të ofrojë asnjë formë *kaffaraje*, personi do të mbetet përgjegjës për atë gjersa të arrijë aftësinë për ta kryer, çka përbën rregullën e Sheri'atit për këtë rast.

Hanbelitë janë të opinionit që nëse ai nuk është në gjendje të japë *kaffarah*, detyrimi i tij resht, madje edhe në rast se aftësohet për këtë më vonë, atij nuk obligohet me asgjë.

Shkollat pajtohen se numri i *kaffarave* do të jetë i barabartë me numrin e shkaqeve që i sjellin ato. Kështu, personi që ndërpret dy agjërimet do të duhet të japë dy *kaffara*. Por nëse ha, pi ose kryen marrëdhënie seksuale disa herë në një ditë, hanefitë, malikitë dhe shafi'itë vërejnë: numri i *kaffarave* nuk do të rritet me rritjen e shkaqeve ndërprerëse, pavarësisht nga lloji i tyre.

Hanbelitë pohojnë: nëse në një ditë të vetme ndodhin disa shkelje që kërkojnë *kaffarah* dhe person jep *kaffarah* për shkeljen e parë të agjërimin përpara kryerjes së të dytës, ai do të japë *kaffarah* edhe për shkeljen e dytë, por nëse nuk ka dhënë *kaffarah* për shkeljen e parë përpara se të kryejë të dytën, atëherë mjafton një *kaffarah* e vetme.

Sipas imamive, nëse marrëdhënia seksuale përsëritet disa herë në një ditë të vetme, numri i *kaffarave* rritet gjithashtu përpjesëtimisht, por nëse personi ha ose pi disa herë, mjafton një *kaffarah* e vetme.

Agjërimet e ndaluara:

Me përjashtim të hanefive, të gjitha shkollat pajtohen se agjërimi në ditët e dy bajrameve ('*Id el-Fitr* e '*Id el-Adha*) është i ndaluar (*haram*). Hanefitë vërejnë: agjërimi në këto dy bajrame është *mekruh* shumë pranë *haramit*.

Imamitë vërejnë: agjërimi në ditët e *Teshrikut* ndalohet vetëm për ata që janë në Mina. Ditët e *Teshrikut* janë 11, 12 e 13 Dhu'l-Hixhheh.

Shafi'itë janë të mendimit se agjërimi nuk vlen në ditët e *Teshrikut*, si për haxhinjtë, edhe për të tjerët.

Sipas hanbelive, është *haram* të agjërohet në këto ditë për ata që nuk kryejnë haxh, jo për haxhinjtë.

Hanefitë vërejnë: agjërimi në këto ditë është *mekruh* shumë pranë të qenit *haram*.

Malikitë pohojnë: është *haram* të agjërohet më 11 e 12 Dhu'l-Hixhheh, për ata që nuk kryejnë haxhin, jo për haxhinjtë.

Të gjitha shkollat përveç hanefive pajtohen se agjërimi mustehhab i një gruaje që nuk ka marrë lejen e të shoqit është i pavlefshëm nëse interferon me plotësimin e cilësdo të drejte të tij. Hanefitë vërejnë: agjërimi i një gruaje pa lejen e të shoqit është *mekruh*, jo *haram*.

Ditët e dyshimta:

Ekziston njëzëshmëri mes shkollave se *imsaku* është detyrim për atë që nuk agjëron në një "ditë të dyshimtë" (*jeum el-shakk*), e cila më vonë del se ka qenë ditë e Ramazanit, dhe ai obligohet me *kada'në* e saj më vonë.

Lidhur me agjërimin në një ditë të dyshimtë, e cila më vonë merret vesh se ka qenë ditë e Ramazanit, ato dallojnë nëse kjo mjafton pa kërkuar *kada'*.

Shafi'itë, malikitë dhe hanbelitë vërejnë: ky agjërim nuk do të mjaftojë dhe *kada'*ja e tij është *waxhib*.

Sipas hanefive, ai mjafton pa kërkuar *kada'*.

Shumica e imamive pohojnë: *kada'*ja e tij nuk është *waxhib* për atë, me përjashtim të rastit kur ai ka agjëruar me nijjetin e Ramazanit.

Agjërimet të pëlqyeshme:

Agjërimi konsiderohet *mustehabb* në të gjitha ditët e vitit përveç atyre në të cilat është ndaluar. Por ka ditë në të cilat agjërimi është theksuar posaçërisht dhe ato përfshijnë tri ditë të çdo muaji, preferueshmërisht ditët me hënë (*el-'ajjam el-bid*), që janë datat 13, 14, 15 të çdo muaji hënor. Mes tyre është Dita e 'Arafatit (9 Dhu'l-Hixhheh). Të theksuara janë gjithashtu ditët e muajve Rexheb dhe Sha'ban. Agjërimi të hënave dhe marteve është theksuar po ashtu. Ka edhe ditë të tjera, që janë përmendur në vepra më të hollësishme. Ekziston njëzëshmëri mes të gjitha shkollave juridike se agjërimi në këto ditë është *mustehabb*.

Agjërime të papëlqyeshme (*mekrah*):

Në veprën *el-Fikh 'ala el-medhahib el-'arba`ah* shkruhet se është *mekruh* të ndahen të premtet dhe të shtunat për agjërime dhe po kështu Nouruzi (21 Marsi) – sipas të gjitha shkollave, përveç shafi'ive, si dhe agjërime në njërin ose dy ditët përpara Ramazanit.

Ndërsa në librat imami të fikhut është pohuar se përbën *mekruh* që miku të agjërojë pa lejen e pritësit, fëmija pa lejen e prindit, si dhe në rast dyshimi për hënën e re të Dhu'l-Hixhjes, dhe mundësinë vijuese që dita është ajo e bajramit.

Dëshmia e hënës së re:

Ekziston njëzëshmëri e plotë mes muslimanëve se shikuesi i hënës së re është i detyruar të veprojë në përputhje me dijen e tij, qoftë ajo hëna e re e Ramazanit apo e Shewwalit. Ndaj, ai që ka shikuar të parën e ka *waxhib* të agjërojë, edhe nëse të gjithë të tjerët nuk agjërojnë[2] e të përmbahet nga të agjëruarit kur e sheh të dytën, edhe nëse të gjithë mbi tokë agjërojnë, pavarësisht nëse vëzhguesi është *'adil* ose jo, burrë apo grua. Shkollat dallojnë lidhur me pikat e mëposhtme:

1. Hanbelitë, malikitë dhe hanefitë pohojnë: nëse të shikuarit (*ru'jeh*) e hënës së re është konfirmuar në një rajon të caktuar, njerëzit e të gjitha rajoneve të tjera obligohen prej kësaj pavarësisht nga distanca mes tyre; dallimi në horizontin e hënës së re nuk ka ndikim.

Imamitë dhe shafi'itë pohojnë: nëse njerëzit e një vendi të caktuar e shohin hënën e re, ndërsa ata të një tjetri jo, kur këto vende janë pranë me horizont, të dytë do të ndjekin të parët, por jo nëse horizontet e tyre dallojnë.

2. Nëse hëna e re shihet gjatë ditës, qoftë para mesditës apo pas saj, më 30 Sha'ban, a do të konsiderohet ajo si dita e fundit e Sha'banit (me ç'rast, agjërime në të nuk do të jetë *waxhib*)? Po kështu, nëse hëna e re shihet gjatë ditës së 30^{te} të Ramazanit, a do të llogaritet si ditë e Ramazanit apo e Shewwalit? Me fjalë të tjera, a do të llogaritet dita në të cilën vërehet hëna e re si: e muajit në kalim apo atij në vijim?

Imamitë, shafi'itë, malikitë dhe hanefitë vërejnë: ajo i përket muajit të kaluar e jo të ardhshmit. Për pasojë, është *waxhib* të agjërohet në ditën vijuese në rastin e shikimit të saj në fund të Sha'banit dhe të ndërpritet agjërime në rastin e shikimit të saj në fund të Ramazanit.

3. Shkollat pajtohen se hëna e re konfirmohet me shikim, sikurse tregohet në këtë hadith profetik:

“Agjëroni kur të shihni hënën e re dhe ndaloni kur ta rishihni!”

Ato dallojnë në lidhje me metodat e konfirmimit të saj.

Imamitë vërejnë: ajo konfirmohet si për Ramazanin, ashtu edhe për Shewwalin me *tewatur* (pra dëshminë e një numri mjaftueshmërisht të lartë njerëzish, kompleti i të cilëve për pohim të rremë është i pamundur), dhe nga dëshmia e dy burrave 'adil, pavarësisht nëse qielli është i kthjellët ose me re dhe nëse i përkasin të njëjtit qytet apo dy qyteteve fqinje, me kusht që përshkrimet e tyre të mos jenë kundërthënëse. Dëshmia e grave, fëmijëve, burrave *fasik* dhe atyre me karakter të panjohur nuk pranohet.

Hanefitë bëjnë dallim ndërmjet hënave të reja të Ramazanit dhe Shewwalit, duke pohuar se: hëna e re e Ramazanit konfirmohet nga dëshmia e një burri të vetëm dhe një gruaje të vetme, me kusht që të jenë muslimanë dhe 'adil. Hëna e re e Shewwalit konfirmohet vetëm me dëshminë e dy burrave ose të një burri dhe dy grave. Kjo në rastin kur qielli nuk është i kthjellët. Kur është vranësirë - pavarësisht nëse bëhet fjalë për hënën e re të Ramazanit apo të Shewwalit - hëna e re konfirmohet vetëm me dëshminë e një numri të konsiderueshëm personash, raportimi i të cilëve sjell siguri.

Sipas shafi'ive, hëna e re e Ramazanit dhe Shewwalit konfirmohet nga dëshmia e një dëshmitari të vetëm, me kusht që ai/ajo të jetë musliman/e, mendësisht i/e shëndoshë dhe 'adil/e. Gjendja e qiellit nuk ndikon.

Sipas malikive, hëna e re e Ramazanit dhe Shewwalit konfirmohet vetëm nga dëshmia e dy burrave 'adil, pavarësisht nëse qielli është i kthjellët apo me re.

Hanbelitë pohojnë: hëna e re e Ramazanit konfirmohet nga dëshmia e një burri ose gruaje 'adil/e, ndërsa ajo e Shewwalit vetëm me dëshminë e dy burrave 'adil.

4. Me përjashtim të hanefive, ekziston njëzëshmëri mes shkollave që: nëse askush nuk pohon ta ketë parë hënën e re të Ramazanit, agjërimi do të jetë *waxhib* pas datës 30 Sha'ban. Sipas hanefive, agjërimi bëhet *waxhib* pas ditës së njëzet e nëntë të Sha'banit.

Sa i përket hënës së re të Shewwalit, hanefitë dhe malikitë vërejnë: nëse qielli është i vranët, tridhjetë ditë të Ramazanit duhen plotësuar dhe ndërprerja (*iftar*) do të jetë *waxhib* ditën e ardhshme. Por nëse qielli është i kthjellët, agjërimi pas datës 30 është *waxhib* duke hedhur poshtë dëshminë e mëparshme të atyre që kanë konfirmuar ditën e parë të Ramazanit, pavarësisht nga numri i tyre.

Shafi'itë e konsiderojnë *iftarin waxhib* pas tridhjetë ditëve, edhe sikur fillimi i Ramazanit të jetë konfirmuar nga dëshmia e një personi të vetëm, pavarësisht nëse qielli është i vranët apo i kthjellët.

Sipas hanbelive, nëse fillimi i Ramazanit është konfirmuar nga dëshmia e dy burrave 'adil, *iftari* pas ditës së tridhjetë është *waxhib*, dhe nëse është konfirmuar nga dëshmia e një 'adili të vetëm, është *waxhib* të agjërohet edhe në ditën e tridhjetë e njëjtë.

Sipas Imamive, edhe Ramazani edhe Shewwali konfirmohen pas plotësimit të tridhjetë ditëve, pavarësisht nga të qenit e qiellit i vranët apo i kthjellët, me kusht që fillimi i tij të jetë konfirmuar në një mënyrë të miratuar nga Sheri'ati.

Hëna e re dhe astronomia:

Këtë vit (1960), qeveritë e Pakistanit dhe Tunizisë kanë vendosur të mbështeten në opinionin e astronomëve për konfirmimin e hënës së re, për t'i dhënë fund konfuzionit [3] dhe paleverdisë së përgjithshme që sjell mosnjohja paraprake e ditës së Bajramit, e cila herë vjen befás e herë shtyhet, megjithë tërë ato përgatitje.

Ky vendim i dy qeverive është bërë çështje debati të nxehtë në qarqet fetare.

Protagonistët e ndryshimit vërejnë se nuk ka asgjë në fe që të kundërshtojë mbështetjen në opinionin e astronomëve; përkundrazi, një gjë e tillë mbështetet nga ajeti 16 i Sures en-Nahl:

{...Dhe shenja të tjera (ditën); ndërsa (natën) orientohen përmes yjeve}

Kundërshtuesit thonë: ky vendim i bie ndesh hadithit të lartpërmendur profetik:

“Agjëroni kur të shihni hënën e re dhe ndaloni kur ta rishihni!”

Kjo sepse fjala *ru'jeh* (shikim) nënkupton të shikuarit e hënës me sy, që ishte praktikë e zakonshme për njerëzit në kohën e Pejgamberit (s.a.v.s). Sa i përket përdorimit të teleskopit ose mbështetjes në llogaritje astronomike, ato janë të papërputhshme me kuptimin e fjalëpërfjaltë të hadithit, theksojnë ata.

Në të vërtetë, asnjëra palë nuk ka parashtruar arsye të shëndosha, sepse ‘udhëzim nga yjet’ nënkupton përcaktimin e rrugëve tokësore dhe detare me ndihmën e yjeve e jo përcaktimin e ditëve të muajit dhe hënës së re. Sa i përket hadithit, ai nuk i bie ndesh dijeve të saktë shkencore, sepse ‘të shikuarit’ është mjet i arritjes së dijeve e jo qëllim më vete, siç është dhe rasti me çdo mjet që ndihmon në konfirmimin e fakteve. Por, sipas mendimit tonë, gjykimet e astronomëve nuk shpiejnë në dituri të sigurtë e as nuk i heqin të gjitha dyshimet, siç është rasti me shikimin, sepse gjykimet e tyre mbështeten në probabilitet e jo në siguri. Kjo është e qartë nga gjykimet e tyre divergjuese mbi netët e hënës së re, kohën e lindjes së saj dhe periudhën gjatë së cilës ajo rri (mbi horizont).

Në ardh të koha që astronomët të arrijnë dije të saktë dhe të mjaftueshme shkencore, në mënyrë që të ekzistojë njëzëshmëri mes tyre dhe ata vërtetohen se kanë të drejtë vazhdimisht, në atë shkallë sa parashikimet e tyre bëhen gjë e sigurtë sikurse ditët e javës, atëherë do të jetë e mundur të mbështetemi tek ata. Madje, atëherë do të jetë e detyrueshme të ndiqen gjykimet e tyre dhe të refuzohet gjithçka që u bie ndesh atyre.[4]

SHËNIME:

[1] Afërsisht 800 gramë miell ose diçka e ngjashme me të.

[2] Mirëpo hanefitë vërejnë: nëse ai dëshmon përpara një kadiu që ia hedh poshtë dëshminë, ai e ka *waxhib* të kryejë *kada'në* e tij pa u ngarkuar me *kaffarah* (*el-Fikh 'ala el-medhahib el-'arba`ah*).

[3] Më 1939, Kurban Bajrami u festua të hënën në Egjipt, të Martën në Arabinë Saudite dhe të mërkurën në Bombei.

[4] Drejtojuni shtjellimit të kësaj çështjeje në vëllimin e parë të librit tonë *Fikh el-Imam Xha'fer es-Sadik*, seksioni i provës së hënës së re në fund të kreut të agjërimit.